- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratëmbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratëmbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati / Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

I përcaktuar në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimore (**2017, 2018, 2019**), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

2. Xhiro mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (**2017, 2018, 2019**), lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me vogel se 50 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

3. Një dokument që vërteton se ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku ka ushtruar dhe ushtron aktivitetin e tij për vitin **2020**.

3.1) Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga njesia vendore në të cilën ka vendushtrim aktiviteti sipas QKB-së.

2.3 Për kapacitetin teknik:

1. **Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **40%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- ❖ Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:
 - Për kontrata të realizuara me autorite publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9 (*Formulari i vleresimit*), shoqëruar me:
 - Kontratë;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;
 - Fatura tatimore për cdo situacion punimesh.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë;
 - Reference/vertetim punimesh nga Investitori;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimin e objektit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;
 - Fatura tatimore për cdo situacion punimesh.

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P - 1 - A *Punime gjërmimi në tokë.*

N.P - 4 - B *Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.*

N.P - 5 - A *Punime nëntoksore, ura e vepra arti*

N.P - 7 - D *Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.*

N.P - 12 - B *Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S - 1 - A *Punime për prishjen e ndërtimeve*

N.S - 9 - A *Punime strukturore speciale.*

N.S - 18 - A *Punime topogjeodezike.*

sipas modelit të lëshuar nga MPPT ;

3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt (Ing Hidroteknik), të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në marrëdhënie pune në subjekte të tjera publike apo private, në kontrata të tjera, si dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

I cili te jete i Certifikuar per Sigurine ne Kantier si dhe i Certifikuar per ”Sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015”.

Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- **Certifikatë “Kordinator i Sigurisë në Kantier”;**
- **”Sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015”, ose ekuivalente;**
- **Diplomë,**
- **Kontratë pune**

si edhe të figurojë në listepagesa **6 mujorin e fundit.**

4. Operatori/ët ekonomik/ë ofertues duhet të kenë të punësuar minimumi një staf prej 60 (gjashëdhjetë) personash, për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën **Gusht 2020 - Janar 2021.**
- b) Listepagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Gusht 2020 - Janar 2021**, të konfirmuara nga organet përkatëse.

5. Operatori/ët ekonomik/ë pjesëmarrës në garë në këtë procedurë prokurimi duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton se Operatori Ekonomik duhet të ketë si staf teknik, të cilët të figurojnë të regjistruar në listepagesa si dhe në licensën e shoqërisë të paktën për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021, inxhinierët e mëposhtëm:

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet 1 (një)

Për sa më sipër duhet të paraqesë:

- kontratë pune e vlefshme;
- diplomë;
- CV;
- librezë pune,

si dhe të jenë në listëpagesa të pakten 6 mujorin e fundit.

6. OE ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente ;**
- **BS OHSAS 18001 : 2007 / 45001 : 2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente ;**
- **ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalente .**
- **ISO 1452-1:2009 (Sisteme tubacione për furnizimin me ujë nën dhe mbi tokë) ose ekuivalente .**

Certifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me kohë të plotë stafin si më poshtë:

- Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar **1 (një) Inxhinier Mekanik/Mekatronik** për makineritë/paisjet elektromekanike që do të angazhohen, me kontratë noteriale, diplomë, dëshmi sigurimi teknik ISHTI-IQT, si edhe të jetë në listëpagesa të paktën **6 mujorin e fundit.**

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek** të punësuar **ose** me kontratë **ose** të jetë **në një marrëdhënie kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim**, bazuar në Ligjin Nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM Nr.108, datë 9.2.2011 "Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" (i ndryshuar).

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës;

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Diplomë;
- Urdhër Mjeku

Ose

- Kontratë me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim,

si edhe të jetë në listëpagesa të paktën 6 mujorin e fundit.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën **6 (gjashtë) Manovradorë** të paisur me Leje/dëshmi përkatëse (leje manovrimi), si dhe **10 (dhjetë) drejtues automjetesh** (shoferë), me kontrate pune si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 6 mujorin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të ketë të paktën **1 (një) Teknik të mesëm ndërtimi**, për të cilin të paraqitet kontratë pune, diplomë, të jetë i pajisur me dëshmi sigurimi teknik nga ISHTI-IQT ose ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesa të paktën 6 mujorin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij minimalisht **1 (një) Inxhinier Ndërtimi** i cili të jetë në listëpagesa të paktën 6 mujorin e fundit, për të cilin të paraqiten: diplomë, CV, kontratë pune, librezë. dhe **20 punonjës/specialistë** të pajisur me dëshmi sigurimi teknik nga ISHTI-IQT ose *Ekuivalente*. Të cilet te jete ne listepagesa te paktën 6 mujorin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar të paktën **2 (dy) punonjës**, të çertifikuar për punime në *skarpata (lartesi)*, si dhe te jene në Listëpagesa të paktën 6 mujorin e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë ne stafin e tij minimalisht **1 (një) Ekspert zjarrfikës** me kontratë pune noteriale dhe lejen perkatese, i cili të figurojë në listëpagesa të paktën 6 mujorin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimalisht **4 (kater) Hidraulik** me kontratë pune dhe dëshmi/certifikatë përkatëse, si dhe të figurojnë në listëpagesa të paktën 6 mujorin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimalisht **2 (dy) Specialist Montues Tuba** me kontratë pune dhe dëshmi/certifikatë përkatëse, si dhe të figurojnë ne listepagesa të paktën 6 muajt e fundit.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimalisht **2 (dy) Saldator** me kontratë pune dhe dëshmi/certifikatë përkatëse, si dhe të figurojnë ne listepagesa të pakten 6 muajt e fundit

8. Operatori Ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik (Shtojca 10).

Kërkohen të jenë në dispozicion këto makineri, pajisje e mjete pune:

NR.	EMRI I MJETIT	SASIA	NJËSI	STATUSI
1	Kamion kapacitet mbajtës mbi 18 ton	8	cope	Pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës (1-2.5 ton)	4	cope	Pronësi ose me qera
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3-4 ton)	4	cope	Pronësi ose me qera
4	Kamion me vinc	2	cope	Pronësi ose me qera
5	Eskavatore me zinxhire	2	cope	Pronësi ose me qera
6	Eskavator me goma	1	cope	Pronësi ose me qera
7	Buldozer	2	cope	Pronësi ose me qera
8	Minieskavatore	6	cope	Pronësi ose me qera
9	Autobetoniere	4	cope	Pronësi ose me qera
10	Autopompe betoni	2	cope	Pronësi ose me qera
11	Rrul Gome – Gome per Asfalt mbi 14 ton	1	cope	Pronësi ose me qera
12	Rrul Hekur – Hekur mbi 10 ton	1	cope	Pronësi ose me qera
13	Rrul Vibrues Gome – Hekur mbi 18 ton	1	cope	Pronësi ose me qera
14	Rrul me Kompresor dhe Vibrim min.10 ton	1	cope	Pronësi ose me qera
15	Autobitumatrice	2	cope	Pronësi ose me qera
16	Kamion i paisur me cikrik	1	cope	Pronësi ose me qera
17	Asfaltoshtruese	2	cope	Pronësi ose me qera
18	Autobot uji kapacitet mbajtës min. 5000 litra	1	cope	Pronësi ose me qera
19	Autovinc kapacitet min. 10 ton	1	cope	Pronësi ose me qera
20	Grejder	3	cope	Pronësi ose me qera
21	Paisje topografike GPS	2	cope	Pronësi ose me qera
22	Nivelues lazer	2	cope	Pronësi ose me qera
23	Aparat saldimi tuba plastik	2	cope	Pronësi ose me qera
24	Gazogjen	1	cope	Pronësi ose me qera
25	Freze per frezim rruge	2	cope	Pronësi ose me qera
26	Motosaldatrice	2	cope	Pronësi ose me qera
27	Pompe testimi rrjeti minimumi 25 bar	4	cope	Pronësi ose me qera
28	Matrapik	2	cope	Pronësi ose me qera
29	Batipal	1	cope	Pronësi ose me qera
30	Kompresor	2	cope	Pronësi ose me qera
31	Ngrites Pirun	2	cope	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

32	Tokmak	3	cope	Pronësi ose me qera
33	Vibrator	3	cope	Pronësi ose me qera
34	Vibrator Hidraulik Shpues Thellesie	1	cope	Pronësi ose me qera
35	Sondë për shpime, mikrotunele horizontale	1	cope	Pronësi ose me qera
36	Prerese dhe kthyese hekuri	1	cope	Pronësi ose me qera
37	Vinc minimumi 10 ton	2	cope	Pronësi ose me qera
38	Vinc kollon min. 1.5 ton, lartesi 40 ml	2	cope	Pronësi ose me qera
39	Motobetoniere kapacitet min. 0.5m3	2	cope	Pronësi ose me qera
40	Karro dore	40	cope	Pronësi ose me qera
41	Fikse zjarri	5	cope	Pronësi ose me qera
42	Kuti te ndihmes se shpejte	5	cope	Pronësi ose me qera
43	Gjenerator te pakten 50 Kw	5	cope	Pronësi ose me qera
44	Semafore sinjalistike per punime rrugore	1	cope	Pronësi ose me qera
45	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	50	cope	Pronësi ose me qera
46	Projektor ndricimi	5	cope	Pronësi ose me qera
47	Rimorkiator - Terheqes	2	cope	Pronësi ose me qera
48	Rimorkio per transportin e makinerive	2	cope	Pronësi ose me qera

- Për mjetet e transportit duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme), foto te mjeteve, Për mjetet e siguruara me qera, dokumentat e mësipërme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit.
- Për paisjet dhe mjetet e tjera të paaqiten fatura tatimore të blerjes ose deklarata doganore. Në rastet e sigurimit me qera të paisjeve dhe mjeteve duhet kontratë noteriale shoqëruar me fatura tatimore ose deklaratat doganore.
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, (*Autobitumatrice*) duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatëse (*e vlefshme*).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e saktë të mjeteve të deklarurara me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor. AK rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruarra sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga përfaqesuesi i shoqërisë ofertuese).
Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".
- Operatori/ët ekonomik/ë ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate.

Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve gjatë gjithë zbatimit të kontratës.

9. Operatori/ët ekonomikë pjesëmarrës në garë për këtë procedurë prokurimi, duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të asfaltit, për këtë duhet të paraqesin dokumentacionin për:

Fabrikë Asfalti me QKL: Në Pronësi / Kontratë noteriale qeraje / Kontratë noteriale furnizimi.

Për sa më sipër duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë apo marrjes me qera, apo kontratë noteriale furnizimi, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

QKL - Fabrike asfalti – Leje Mjedisi tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga Organe të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të paktën 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 155 °C deri në 170 °C, OE ofertues duhet të mbajë parasysh se Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit (*në pronësi/kontratë qeraje/kontratë furnizimi*) duhet të jetë në një distancë jo më të largët se 40 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit. Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit të jetë **jo më pak se 140 °C**, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe V.K.M. Nr. 628, datë 15.07.2015.

10. Operatori/ët ekonomikë pjesëmarrës në garë për këtë procedurë prokurimi, duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të betonit, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin për:

Fabrikë/impiant betony: Në pronësi / Kontratë noteriale qeraje / Kontratë noteriale furnizimi.

Për sa më sipër duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë apo marrjes me qera, apo kontratë noteriale furnizimi, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

Leje (QKB/QKL) - Fabrikë/impiant Betoni – Leje Mjedisi tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së betonit nga prodhuesi, si dhe të shoqërohet me Raport Monitorimi nga organe të akredituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të paktën 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

11. Operatori/ët ekonomik/ë apo bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratë/Marrëveshje noteriale furnizimi të lidhur me Prodhuës ose Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për tuba & materialet hidraulike me volumet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor ne preventivin e tenderit, ku te jepet adresa e sakte dhe kontakti si: telefon, fax, e-mail i furnitorit. Kontrata/Marreveshja e furnizimit duhet të pershkruajë garantimin e materialeve përgjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të prokurimit.

12. Operatori/et ekonomike ofertues duhet:

- Të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB/QKL) **Kodi III.7.A “Shërbime profesionale për zbatime”**.
- Të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB/ QKL) **Kodi III.2. B “Transport i mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimet dhe prishjet”**.

13. Cdo ofertues duhet të paraqesë edhe **Grafikun e Punimeve** në përputhje me afatin e realizmit të punimeve të kërkuara.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

→ Sipas Dokumentave bashkangjitur DST – së.

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: **Sipas Dokumentave bashkangjitur DST-së.**

Specifikimet Teknike të Materialeve: **Sipas Dokumentave bashkangjitur DST-së.**

Dokumenta Standarde të Tenderit

Grafiku i Punimeve:

NR.	EMERTIMI I PUNIMEVE	Muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
	PUNIME NDERTIMI														
1	PUNIME GERMIMI														
2	PUNIME NE NDERTIMIN E TUBACIONEVE														
3	PUNIME MBUSHJE														
4	PUNIME NE NDERTIMIN E PUSHTAVE TE MANOVRIMIT														
5	PUNIME NE SHITESA RRUGORE														

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

PREVENTIVI I PUNIMEVE						
OBJEKTI: ” RIKONSTRUKSIONI I LINJËS SË DËRGIMIT NGA STP – GAJDE NË STP – TOSHKËZ ”						
Nr.	An	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	LINJAT E DERGIMIT					
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m ³	8,281.6	-	-
2	3.46/1	Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m ³	2,069.0	-	-
3	Anal_R - 1	Transport materiale ndertim, dheu me auto deri 15 km	m ³	8,482.0	-	-
4	2.426/3	Prishje shtrese betoni	m ³	21.0	-	-
5	Anal_R - 2	Prerje Asfalti	m ²	2,100.0	-	-
6	3.226/1	Shtrese Asfaltobetoni 4 cm	m ²	2,100.0	-	-
7	3.222/2	Shtrese binderi t = 6 cm	m ²	2,100.0	-	-
8	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m ²	2,100.0	-	-
9	3.212/d	Shtrese stabilizanti t = 20 cm	m ²	2,100.0	-	-
5	2.19	Mbushje ngjeshje me material te germuar	m ³	1,860.0	-	-
10	3.352	Mbushje ngjeshje gure kave	m ³	7,530.0	-	-
11	Anal_R - 3	F.V. Tub PE 100 RC DN/OD 315 mm PN 20 atm SDR 9	ml	2,520.0	-	-
12	Anal_R - 4	F.V. Tub PE 100 RC DN/OD 315 mm PN 16 atm SDR 11	ml	1,580.0	-	-
13	Anal_R - 5	F.V. Tub PE 100 RC DN/OD 315 mm PN 10 atm SDR 17	ml	1,990.0	-	-

Dokumenta Standarde të Tenderit

14	Anal_R - 6	F.V. Tub PE 100 RC DN/OD 110 mm PN 20 atm SDR 9	ml	1,005.0	-	-
				Shuma 1		-
2	Kalim me tub çeliku					
1	3.46/1	Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m ³	95.00	-	-
2	2.536	F.V tuba çeliku Ø deri 200 mm	kg	4,320.00	-	-
3	Anal_R - 1	Transport materiale ndertim, dheu me auto deri 15 km	m ³	95.00	-	-
4	2.130/1a	Beton M-200 per kalimet me tub çeliku	m ³	5.60	-	-
				Shuma 2		-
2	Puseta Tip e lidhjes					
1	4.113/10	F.v. Fllanxhe çeliku DN 300 mm Pn 25 bar	cope	1	-	-
2	Anal_R - 7	F.V. Tee Gize me Fllanxhe DN 300/300 mm PN 25 bar	cope	2	-	-
3	Anal_R - 8	F.v Saraçineskë flutur DN 300 mm, Pn 25 bar	cope	3	-	-
4	Anal_R - 9	F.V. Tub gize FFG DN 300 mm me fllanxha Pn 25 bar L = 1000 mm	cope	1	-	-
5	Anal_R - 10	F.V.Matës uji Induktiv me fllanxha DN 300 mm PN 16 bar	cope	1	-	-
6	Anal_R - 11	F.V. Tub gize FFG DN 300 mm me fllanxha Pn 25 bar L = 800 mm	cope	1	-	-
7	Anal_R - 12	F.V.Pjese çmontuese Gize DN 300 mm PN 25 bar	cope	2	-	-
8	Anal_R - 13	F.V. Tub gize FFG DN 300 mm me fllanxha Pn 25 bar L = 500 mm	cope	2	-	-
9	Anal_R - 14	F.V. Brry190 ° DN 300 mm PN 25 bar	cope	2	-	-
10	Anal_R - 15	F.V. Tub gize FFG DN 300 mm me fllanxha Pn 25 bar L = 2500 mm	cope	1	-	-
11	Anal_R - 16	F.V.Fllanxhe adaptor per Tub PE 100 DN /OD 315 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
				Shuma 2		-
3	Puseta Tip ajruesi					
1	Anal_R - 16	F.V.Fllanxhe adaptor per Tub PE 100 DN /OD 315 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
2	Anal_R - 12	F.V.Pjese çmontuese Gize DN 300 mm PN 25 bar	cope	1	-	-

Dokumenta Standarde të Tenderit

3	Anal_R - 17	F.V. Tee Gize me Fllanxe DN 300/200 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
4	Anal_R - 18	F.v Saraçineskë flutur DN 200 mm, Pn 25 bar	cope	1	-	-
5	Anal_R - 19	F.V. Ajrues me tre funksione DN 200 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
				Shuma 3		-
				Shuma 3 (3 cope)		-
4	Puseta Tip 1					
1	Anal_R - 16	F.V.Fllanxe adaptor per Tub PE 100 DN /OD 315 mm PN 25 bar	cope	2	-	-
2	Anal_R - 20	F.V. Tee Gize me Fllanxe DN 300/125 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
3	Anal_R - 12	F.V.Pjese çmontuese Gize DN 300 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
4	Anal_R - 21	F.v Saraçineskë me volant DN 125 mm, Pn 25 bar	cope	1	-	-
5	Anal_R - 22	F.V.Pjese çmontuese Gize DN 125 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
6	Anal_R - 23	F.V.Fllanxe adaptor per Tub PE 100 DN /OD 125 mm PN 25 bar	cope	1	-	-
				Shuma 4		
5	Pusete tip 500 x 300 cm					
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m ³	22.4	-	-
2	Anal_R - 1	Transport materiale ndertim, dheu me auto deri 15 km	m ³	22.4	-	-
3	2.258	Shtrese zavorri nen pusete t = 10 cm	m ³	2.2	-	-
4	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 t = 10 cm	m ³	2.2	-	-
5	3.244/1	Beton C 20/25 per ndertim pusete	m ³	21.916	-	-
6	3.244/1	Beton C 20/25 per mbeshtetjen e rakorderive	m ³	1.989	-	-
7	Anal_R - 24	Transport betoni me autobetonjere 14.0 km	m ³	26.3	-	-
8	3.287	Hekur betoni per armim	ton	2.60	-	-
9	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama	m ²	70.6	-	-
10	3.An/fh	F.v Waterstop gome b = 20 cm	ml	18	-	-

Dokumenta Standarde të Tenderit

11	Anal_R - 25	F.v kapak gize EN 124 klasa D 400 hyrje rrethore D = 620 mm	cope	1	-	-
12	Anal_R - 26	F.v Shkallë hekuri, EN 13101, gizë, njëshe, pikëmbështetje: 300 x 150 mm, për bashkim përfshirë materialin fiksues	cope	10	-	-
13	2.536	F.v tub çeliku per ajrim pusete DN 51.0/4.0 mm L = 300 cm	kg	14	-	-
				Shuma 5		
6	Pusete tip manovrimi 150 x 150 x 130 cm					
1	2.5/a	Germim kanali me krahe	m ³	8.6	-	-
2	Anal_R - 1	Transport materiale ndertim, dheu me auto deri 15 km	m ³	8.6	-	-
3	2.258	Shtrese zavorri nen pusete t = 10 cm	m ³	0.45	-	-
4	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 t = 10 cm	m ³	0.45	-	-
5	3.244/1	Beton C 20/25 per ndertim pusete	m ³	3.6	-	-
6	3.244/1	Beton C 20/25 per mbeshtetjen e rakorderive	m ³	0.6	-	-
7	Anal_R - 24	Transport betoni me autobetonjere 14.0 km	m ³	4.65	-	-
8	3.287	Hekur betoni per armim	ton	0.60	-	-
9	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama	m ²	18.7	-	-
10	3.An/fh	F.v Waterstop gome b = 20 cm	ml	7.5	-	-
11	Anal_R - 25	F.v kapak gize EN 124 klasa D 400 hyrje rrethore D = 620 mm	cope	1	-	-
12	Anal_R - 26	F.v Shkallë hekuri, EN 13101, gizë, njëshe, pikëmbështetje: 300 x 150 mm, për bashkim përfshirë materialin fiksues	cope	6	-	-
				Shuma 6		-
				Shuma 6 (4 cope)		-
Shuma (1 ÷ 6)						-
T.V.SH 20 %						-
Shuma						-

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

<Emri>

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Dokumenta Standarde të Tenderit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

Dokumenta Standarde të Tenderit

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me ate të perkufizuar ne ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specififikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
